



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr 2091 prot

Tiranë më 23.02.2024

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar neni 9 pika 1, gërma ç; neni 13 e në vijim; Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”, Statutit të TKOBAP dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin e brendshëm për për pozicionin e punës Spalë Sektori Kori (soprano) pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se audicioni do të zhvillohet në **datën 25.03.2024, ora 15:00, në Hollin koncertor** të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhje për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme për vendin vakant Spalë Sektori Kori (soprano) pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.

Të gjithë ata artistë të brendshëm të interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP-së deri në datën 18.03.2024, ora 16:30 një letër shprehje interesi për vendin vakant.

Programi për konkurimin është:

1. Dy arie të epokave të ndryshme nga repertori operistik të përzgjedhura nga vetë konkurenti, përkatësisht nga kompozitorët: W. A.Mozart, G.Rossini, V.Bellini, G.Verdi, G. Puccini, R. Leoncavallo, P. Mascagni, J.Massenet, G. Bizet, Ch. Gounod. R. Wagner
2. Shtrirja vokale (vokalisë)
3. Lexim me shikim të parë
4. Repertori Koral
 - P. Mascagni – Cavaleria Rusticana
Regina Coeli (Preghiera)

- G. Verdi – Messa da Requiem
“Libera me Domine” - Fugato
- G. Rossini – Stabat Mater Nr. 9
Quando corpus morietur
- F. Mendelssohn
Elias – Nr. 5 – Allegro Vivace
Aber der Herr sieht es nicht

5. Komisioni do të vlerësojë edhe këto pika:

- Ecurinë e kandidatit duke marrë parasysh angazhimet e tij edhe si solist në produksione të ndryshme të TKOBAP.
- Performancën skenike si dhe etikën profesionale.
- Aftësitë bashkëpunuese me dirigjentin.
- Aftësitë drejtuese të sektorit që do të përfaqësojë.

Komisioni ka të drejtë:

- Të përzgjedhë materialet të cilat i sheh të arsyeshme të dëgjojë.
- Të dëgjojë deri në fund ose të ndërpresë performancën.
- Të intervistojë kandidatin mbi objektivat e tij.

Shënim:

Nëse kandidatët nuk kanë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor do vendosë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar minimalisht 3 javë përpara.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:

sekretaria@tkob.gov.al

**DREJTORE E PËRGJITHSHME
ABIGEILA VOSHTINA**

